

**Jashtë shteti**

## **Të punosh në Gjermani dhe në Republikën e Shqipërisë**

- > Si ndikon marrëveshja gjermano-shqiptare
- > Cilat janë përfitimet që ju mund të merrni në Gjermani dhe në Republikën e Shqipërisë
- > Partnerët tuaj të kontaktit

## **Të punosh pa kufi**

**Ju tashmë keni punuar për një farë kohe në Shqipëri dhe dëshironi të emigroni atje? Ju jeni shtetas i Republikës së Shqipërisë dhe punoni në Gjermani?**

**Ndoshta ju pyesni veten, se si puna në vende të ndryshme do të ndikojë në pensionin tuaj të mëvonshëm. Në fund të fundit, Republika e Shqipërisë dhe Gjermania kanë sisteme shumë të ndryshme të siguracionit shoqëror.**

**Kjo është e vërtetë por, ne mund t'ju qetësojmë. Gjermania dhe Republika e Shqipërisë kanë mbyllur një marrëveshje, në mënyrë që ju të shmangni sa më shumë disavantazhe.**

**Në këtë broshurë ju do të mësoni se çfarë është marrëveshja gjermano-shqiptare, si ndikon ajo tek e drejta gjermane dhe çfarë të drejtash keni ju në Republikën e Shqipërisë.**

**Por, nëse keni ende pyetje pa përgjigje, ju mund të na drejtoheni ne kurdoherë.**

**Kjo broshurë është shkruar me një kujdes të veçantë. Gjithësesi ne nuk mbajmë përgjegjësi për vërtetësinë e informacionit rreth ligjeve jashtë Gjermanie. Për informacion të saktë mbi ligjet jashtë Gjermanie, ju lutemi t'u drejtoheni zyrave përgjegjëse atje.**

## **Pasqyra e lëndës**

**4 Marrëveshja me Republikën e Shqipërisë**

**7 Të punosh në vendin anëtar të marrëveshjes - ku jam unë i siguruar?**

**10 Të jesh anëtar vullnetar në Gjermani**

**13 Kthimi i kontributeve të paguara në Gjermani**

**17 Rehabilitimi - kapërximi i vështirësive shëndetësore**

**19 Pensioni - cfarë avantazhesh ka marrëveshja**

**23 Kushtet bazë për pensionin gjerman**

**27 Pensioni i duhur gjerman për ju**

**36 Llogaritja e pensionit gjerman**

**39 Sistemi shqiptar i pensionit - një përmbledhje e shkurtër**

**45 Pension gjerman edhe jashtë Gjermanie**

**48 Kërkesa për pension dhe fillimi i pensionit**

**50 Mundësoni shqyrtimin e drejtave tuaja**

**51 Sigurimi shëndetësor dhe ai i përkujdesjes për ju si pensionist**

**53 Partnerët tuaj të kontaktit**

**56 Vetem një hap larg: sigurimi juaj pensional**

## **Marrëveshja me Republikën e Shqipërisë**

### **Gjermani ka mbyllur marrëveshje në fushën e sigurisë sociale me shumë shtete, përfshi edhe Republikën e Shqipërisë.**

Marrëveshja gjermano-shqiptare ka hyre në fuqi më 1 dhjetor 2017. Ajo rregullon marrëdhëniet e Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë në fushën e sigurimeve pensionale shtetore.

#### **Marrëveshja përfshin**

- > parashikimet e ligjeve gjermane mbi sigurimin pensional shtetëror, sigurimin shtesë në shoqërinë e minierave dhe sigurimin e pensionit të vjetërsisë për fermerët dhe
- > parashikimet e ligjeve shqiptare mbi sistemin e sigurimit shoqëror të detyrueshëm për pensionin e vjetërsisë, pensionin e invaliditetit dhe pensionin familjar.

Fushat e tjera të sigurimit shoqëror, si për shembull sigurimi shtetëror shëndetësor dhe i përkujdesjes ose sigurimi për aksidentet, nuk përfshihen prej marrëveshjes.

Marrëveshja lehtëson para së gjithash vjeljen e përfitimeve pensionale duke llogaritur së bashku (p.sh. për plotësimin e kohës së pritjes) kohën e punës në Gjermani dhe atë në Shqipëri për të përmbushur kushtet e të drejtës së përfitimit.

Sidomos shtetasve shqiptarë, të cilët kanë punuar vetëm pak vite në Shqipëri dhe pjesën tjetër të jetës së tyre të punës e kanë në Gjermani, ju bëhet e mundur të përfitojnë pension në Shqipëri.

Për më tepër, marrëveshja rregullon procedurën, se në cilin shtet do të paguhet pensioni kur bëhet fjalë për një punë në Gjermani ose në Republikën e Shqipërisë.

### **Një veçanti**

Kur vërtetohen kushtet për përfitimin e një pensioni nuk merren parasysh vetëm periudhat e punës së siguruar gjermane dhe shqiptare por, nëse është e domosdoshme

- > në Gjermani, edhe të gjitha periudhat e siguruara të një personi, i cili ka paguar kontribute në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian (BE) ose të Tregut të Përbashkët Evropian (TPE) ose Zvicrës, dhe përveç kësaj edhe kontributet që i ka paguar në një shtet, me të cilin Gjermania apo Republika e Shqipërisë kanë bërë një marrëveshje të ngjashme si ajo gjermano-shqiptare mbi sigurimin shoqëror. Deri më tani këtu përfshihen Maqedonia dhe Turqia.
- > Në Republikën e Shqipërisë, edhe periudhat e siguruara të një personi, i cili ka paguar kontribute në një shtet të tretë, në qoftë se Gjermania apo Republika e Shqipërisë kanë bërë një marrëveshje të ngjashme si ajo gjermano-shqiptare mbi sigurimin shoqëror. Nga ana ligjore Shqipëria e cilëson udhëzimin (EG) nr. 883/2004 si marrëveshje mbi sigurimin shoqëror midis disa shteteve dhe kështu llogarit edhe periudhat e siguruara në Belgjikë, Luksemburg dhe Hungari si edhe në Maqedoni dhe Turqi.

**Ju lutemi, vini re:**

**Nëse në këtë broshurë përmendet termi „shtete anëtare“, bëhet fjalë për të gjitha shtetet e Bashkimit Evropian, të Tregut të Përbashkët Evropian, Islandën, Lihtenshtajnin, Norvegjinë dhe Zvicrën.**

**Për cilin vlen marrëveshja mbi sigurimin shoqëror?**

Marrëveshja është një e ashtuquajtur marrëveshje e hapur. Prandaj ajo vlen për të gjithë personat që dikur kanë paguar kontribute sigurimi në Gjermani, në Shqipëri ose në të dyja shtetet, dhe për familjarët në rast vdekjeje. Shteti apo vendbanimi i përfituesve nuk ka rëndësi.

## **Të punosh në vendin anëtar të marrëveshjes – ku jam unë i siguruar?**

**Kryesisht vlej në ligjet e vetëm njërit shtet. Kjo, pra nëse për ju merren parasysh ligjet shqiptare apo gjermane, vendoset prej vendit ku ju, në fakt, keni punuar.**

Nëse ju punoni në Shqipëri, jeni të siguruar sipas të drejtës shqiptare. Nëse punoni në Gjermani, jeni të siguruar sipas të drejtës gjermane. Dhe kjo vlen për të gjitha fushat e sigurimit shoqëror. Domethënë edhe për sigurimin shëndetësor, sigurimin e përkujdesjes, sigurimin për aksidentet si edhe për sigurimin e papunësisë. Ky rregull vlen pavarësisht se në cilin shtet banon punëmarrësi ose në cilin shtet është zyra qendrore e firmës së punëdhënësit.

### **Shembull:**

Bekir Jaha punon si punonjës në Speyer. Meqënëse ai punën e ushtron vetëm në Gjermani, atëherë për të vlej në vetëm ligjet gjermane.

Nese ai do të punonte në Tirane, për të do të vlenin ligjet shqiptare.

Aplikimi i ligjeve shqiptare nuk mund të interpretohet automatikisht si një sigurim shoqëror në Shqipëri. Nëse ekziston dhe në çfarë spektri ekziston sigurimi shoqor për një punë të caktuar në Shqipëri, përcaktohet vetëm nga parashikimet ligjore shqiptare. Megjithatë, marrëveshja bën përjashtime nga ky rregull i përgjithshëm.

### **Dërgimi**

Një dërgim është një rregull i veçantë për një punëmarrës, i cili brenda kornizës së një pune, dërgohet përkohësisht prej punëdhënësit në një shtet tjetër për të kryer punën sipas detyrës që i është ngarkuar nga punëdhënësi. Për dërgimin ka një kufi kohor prej maksimumi 24 muajsh kalendarike.

Kjo do të thotë se, nëse ju jeni punësuar në Gjermani dhe dërgoheni me punë në Shqipëri, për ju vlejnë ende ligjet gjermane. Si rrjedhojë juve ju përfshijnë ligjet gjermane edhe për sigurimin shëndetsor, të përkujdesjes, të papunësisë, dhe për aksidentet, në të njëjtën formë sikur të ishit duke ushtruar punën në Gjermani.

**Ju lutemi, vini re:**

**Marrëveshja nuk përmban rregulla dërgimi për të vetëpunësuarit. Për të vetëpunësuarit, të cilët ushtrojnë punën vetëm përkohësisht në Shqipëri, mund të lihen si të vlefshme ligjet gjermane vetëm nëpërmjet një vendimi të marrë nga një marrëveshje e posaçme.**



### **Marrëveshja e posaçme**

Nëse sipas aplikimeve të mëparshme, për ju vlejnjë ligjet shqiptare, mund të bëhet një marrëveshje e posaçme nëpërmjet një kontrate, në mënyrë që për ju të aplikohen vetëm ligjet gjermane. Nëse mbyllet një marrëveshje e tillë, atëhere ajo vlen për të gjitha fushat e sigurimit shoqëror. Kontrata lidhet pranë GVK – Spitzenverband – jashte shtetit (DVKA).

Adresën e DVKA-së  
e gjeni në faqen 55.

Në këtë mënyrë ju mbeteni të siguruar sipas ligjeve gjermane, edhe nëse do t'ju duhet të punoni në Shqipëri për punëdhënësin tuaj më gjatë se 24 muaj kalendarikë.

### **Sugjerimi ynë:**

Në faqen e internetit të DVKA-së ju mund të gjeni informacione të hollësishme rreth kësaj teme në rubrikën „Të punosh në Shqipëri“.

## **Të jesh anëtar vullnetar në Gjermani**

**Me kontribute vullnetare mund ta rritni pensionin tuaj gjerman, mund të fitoni për herë të parë një të drejtë për pension ose mund të mbushni boshllëqe.**

Nëse ju banoni në Gjermani dhe nuk duhet të paguani kontribute të detyrueshme, pavarësisht nga shtetësia juaj, ju mund të siguroheni vullnetarisht në sigurimin pensional gjerman. Për këtë duhet të jeni të paktën 16 vjeç. Si gjerman ju, përveç kësaj dhe pavarësisht nga vendbanimi, mund të siguroheni në të gjithë botën gjithmonë vullnetarisht në Gjermani.

### **Sugjerimi ynë:**

Informacione më të hollësishme përmban broshura jonë falas "Freiwillig rentenversichert: Ihre Vorteile"

Pavarësisht nga shtetësia dhe nga vendbanimi, të gjithë ata që para dt. 19 tetor të vitit 1972 kanë paguar të paktën një kontribut vullnetar, mund të sigurohen vullnetarisht në Gjermani.

### **Kontributet vullnetare brenda kornizës së marrëveshjes**

Shtetasit shqiptarë me leje qëndrimi të zakonshëm në Republikën Federale Gjermane kanë të drejtën e sigurimit vullnetar në Gjermani pa ndonjë kusht të veçantë.

Në rastin e leje qëndrimit të zakonshëm në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Evropian, ata e gëzojnë këtë të drejtë vetëm nëse më parë kanë paguar të paktën një kontribut në sigurimin pensional gjerman. Nga ana tjetër, nëse shtetasit shqiptarë banojnë jashtë BE-së, për shembull në Shqipëri, ata kanë kryesisht të drejtë të sigurohen vullnetarisht për pension gjerman, vetëm nëse më parë kanë paguar kontribute pranë sigurimit pensional gjerman për 60 muaj.

**Sugjerimi ynë:**

Juve ndoshta mund t'ju kthehen kontributet e paguara pranë sigurimit pensional gjerman. Për këtë lexoni, ju lutemi, kapitullin „Kthimi i kontributeve gjermane“ duke filluar nga faqja 13.

**Kontribute vullnetare: avantazhet tuaja**

Me kontribute vullnetare ju mund ta plotësoni kohën e pritjes për një pension gjerman. Por ju mund ta ruani edhe mbrojtjen tuaj të sigurimit për një pension për shkak të uljes së pjesshme ose të plotë të aftësisë për punë.

**Sugjerimi ynë:**

Për këto pensione mund të jetë me rëndësi që të dëshmoni kohën nga dt. 1 janar i vitit 1984 deri më sot pa boshllëqe me të ashtuquajtura kohët për ruajtjen e të drejtës. Nëse largoheni nga sigurimi shtetëror pensional gjerman, por dëshironi që ta ruani edhe më tej të drejtën për njërin prej këtyre pensioneve, atëherë ju duhet të këshilloheni paraprakisht me ne mbi mundësitë tuaja.

Shumën dhe numrin e kontributeve tuaja vullnetare ju e vendosni vet. Por ka kontribute minimale dhe maksimale.

Vlerat aktuale të kontributeve i gjeni në internet nën [www.deutsche-  
rentenversicherung.de](http://www.deutsche-rentenversicherung.de).

Ju nuk jeni i detyruar që t' i përmbaheni shumë të kontributit që keni zgjedhur një herë. Për të ardhmen ju mund të ndryshoni në çdo kohë shumë të kontributeve dhe pagesën mund ta ndërprisni edhe tërësisht. Kontribute vullnetare për vitin e ardhshëm mund të paguani vetëm deri më dt. 31 mars të vitit pasues.

### **Pagesa e kontributeve**

Përpara se t'ju lejohet që të paguani kontribute vullnetare, duhet të aprovohet fillimisht kërkesa juaj nga institucioni i sigurimit pensional. Pastaj është e këshillueshme që t' i paguani kontributet me transfertë bankare duke i transferuar nga llogaria juaj ose nga ajo e një të autorizuari tek një bankë në Gjermani. Edhe një transferim nga brenda ose jashtë vendit është i mundshëm.

### **Ju lutemi, vini re:**

**Institucioni i sigurimit nuk merr përsipër asnjë shpenzim bankar, shpenzim për transferimin ose ndonjë shpenzime tjetër për transferimin. Në rast të pagesave nga jashtë vendit duhet që të paguani shumë në euro për të përjashtuar diferenca të kursit.**

### **Partnerët tuaj të kontaktit**

Nëse ju dëshironi të bëni një kërkesë për sigurim vullnetar, drejtohuni, ju lutemi, institucionit të sigurimit, i cili e ka të dhënat tuaja, ose përkatësisht ka qënë institucioni juaj i sigurimit i fundit.

Nëse ju banoni në Gjermani dhe nuk keni paguar asnjëherë kontribute për sigurimin shtetëror pensional gjerman, ju mund ta paraqisni kërkesën tek çdo institucion sigurimi.

Ju lutemi, lexoni kapitullin tonë „Vetëm një hap larg: Sigurimi juaj pensional“.

Ju nuk jeni i sigurt, cili institucion sigurimi është përgjegjës për ju? Na pyesni ne. Për këtë ju mund të shfrytëzoni në Gjermani telefonin tonë të shërbimit që është falas ose në të gjithë botën adresën tonë të e-mailit.

## **Kthimi i kontributeve gjermane**

**Nëse në Gjermani keni punuar dhe paguar kontribute vetëm për një kohë të caktuar dhe tani ktheheni në vendlindjen tuaj, ju ndoshta dëshironi që t'ju kthehen kontributet tuaja gjermane. Nëse kjo mundësi ekziston për ju, këtë e mësoni në këtë kapitull. Por ju duhet ta mendoni mirë këtë hap.**

Me kthimin e kontributeve shuhen marrëdhëniet e sigurimit plotësisht. Por kjo, kryesisht, duhet të bëhet vetëm, nëse ju jeni shumë larg rrezes së efektit të kontributeve dhe prej tyre nuk mund të vilet asnjë përfitim.

### **Sugjerimi ynë:**

Informacione të hollësishme rreth kësaj ju mund të gjeni në broshurën tonë: „Beitragserstattung“.

Ju mund ta kërkonti kthimin nëse ju

- > jeni shkëputur nga detyrimi gjerman për t'u siguruar.
- > nuk mund të siguroheni vullnetarisht në Gjermani dhe
- > n.q.s. nga momenti i shkëputjes nga detyrimi gjerman për t'u siguruar kanë kaluar të paktën 24 muaj.

Afati i pritjes prej të paktën 24 muajsh duhet të respektohet. Dhe ndërkohë nuk duhet të ketë filluar një detyrim i ri për t' u siguruar.

Detyrimi për t' u siguruar në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian ose në një vend me të cilin Gjermania ka lidhur një marrëveshje mbi sigurimet shoqërore, në këtë kontekst mund të barazohet me detyrimin për t' u siguruar në Gjermani. Mundësia e kthimit të kontributeve nuk ekziston në këtë rast. Ju lutemi, këshillohuni për këtë.

### **Sugjerimi ynë:**

Nëse lejohet që ju të siguroheni vullnetarisht në Gjermani, e mësoni në kapitullin "Të jesh anëtar vullnetar në Gjermani". Lidhur me këtë nuk luan asnjë rol, nëse me të vërtetë dëshironi që të siguroheni vullnetarisht.

### **Kthim për shkak të moshës**

Nëse ju keni arritur kufirin e moshës së rregullt dhe keni paguar kontribute për më pak se pesë vjet, ju mund të bëni një kërkesë për kthim. Ideja e këtij rregulli është mendimi se me më pak se pesë vjet të pagesës së kontributeve, ju nuk keni të drejtë për pension. Kontributet kthehen atëherë pa afatin e pritjes prej 24 muajsh kalendarikë.

### **Sugjerimi ynë:**

Në ato pesë vjet llogariten edhe periudha e siguruara në Shqipëri. Edhe periudhat për të cilat ju nuk i keni paguar kontributet vetë (për shembull kohët e edukimit të fëmijëve) merren parasysh. Mund të llogaritet edhe periudha e siguruar në shtetet, të cilat aplikojnë të drejtën evropiane. Kështu ju keni ndoshta të drejtë për një pension gjerman.

Kufiri i moshës së rregullt do të ngrihet hap pas hapi nga mosha 65 në 67 vjeç.

Mund të llogariten edhe periudhat në vende të tjera me një marrëveshje.

Familjarët, në rast vdekjeje, mund të kërkojnë kthimin e kontributeve të të ndjerit, nëse ky nuk ka paguar ende kontribute për pesë vjet. Edhe këtu llogariten periudhat e siguruara në Shqipëri.

### **Asnjë kthim**

Kontributet gjermane nuk mund të kthehen, nëse ju tashmë merrni një pension të huaj, dhe ky pension mund të paguhet vetëm, sepse kontributet gjermane dhe të huaja janë llogaritur së bashku.

### **Ju lutemi, vini re:**

**Kontributet nuk mund të kthehen, nëse ju nga këto keni marrë tashmë një përfitim material ose monetar. Kjo mund të ketë qenë për shembull një përfitim për rehabilitimin mjekësor. Por kontributet, të cilat janë paguar pas këtij përfitimi, mund të kthehen.**

Nëse kontributet tuaja kthehen, atëherë marrëdhëniet e sigurimit me sigurimin pensional gjerman shuhen tërësisht. Ju nuk mund të ngrini më asnjë pretendim në bazë të periudhave të siguruara deri në atë moment.

### **Sugjerimi ynë:**

Ju lutemi, këshillohuni hollësisht, përpara se të paraqisni një kërkesë për kthimin e kontributeve. Një pension i mëvonshëm mund të jetë alternativa më e mirë për ju.

### **Kthim vetëm me kërkesë**

Kontributet mund t'ju kthehen vetëm me kërkesë. Ju mund të paraqisni kërkesën tuaj edhe në mënyrë jo formale tek çdo institucion gjerman të sigurimit ose edhe në një ambasadë gjermane ose konsullatë gjermane në vend.

Meqenëse lejohet që ju të paraqisni kërkesën edhe në gjuhën tuaj amtare, atëherë ju nuk keni nevojë të angazhoni një person ndërmjetës ose një të autorizuar ose një përkthyes me gojë.

**Ju lutemi, vini re:**

**Kontributet, si rregull, nuk kthehen në shumën e plotë!**

**Punëmarrësit marrin për shembull vetëm pjesën e tyre të kontributeve të detyrueshme. Nga kontributet vullnetare kthehet vetëm gjysma e tyre dhe kontribute, të cilat nuk janë marrë përsipër nga ju, nuk mund të kthehen fare. Këtu përfshihen për shembull kontribute për shkak të edukimit të fëmijëve. Për kontributet nuk paguhen as interesa.**

### **Shtetasit gjerman**

Si gjerman juve ju lejohet që t'ju kthehen kontributet gjermane parimisht vetëm atëherë, kur ju e keni arritur kufirin e moshës së rregullt dhe keni paguar më pak se 60 kontribute.



## **Rehabilitimi – kapërximi i vështirësive shëndetsore**

**Sigurimi pensional gjerman nuk paguan vetëm pensionin, por edhe kurat (rehabilitimin). Nëpërmjet rehabilitimit bëhet e mundur shmangja ose kapërximi i sëmundjeve dhe aftësive të kufizuara, në mënyrë që ju të mos jeni të detyruar të shkëputeni prej punës para kohe apo të rianëtarësoheni në sigurime.**

Përfitimet për pjesmarrje në kura janë mbi të gjitha pagesa për shërbime mjekësore, të cilat jepen në trajtime ambulante apo shtrim me fjetje. Qëllim i masave të tilla është shmangja e shkëputjes së parakohshme nga puna dhe kështu jeni anëtarë të sigurimit të përhershëm, pa shkëputje. Pagesat për shërbimet gjatë pjesmarrjes në kura iu bëhen kryesisht institucioneve në gjermani, ku kryhet kura.

### **Rehabilitim para pensionit**

Para se ne të paguajmë një pension për shkak të uljes së aftësisë për të punuar, ne vërtetojmë nëse pjesmarrja në një kurë mund të rikuperojë aftësinë për të punuar.

Përveç pagesave për një rehabilitim mjekësor, ka edhe shërbim pagesash për angazhimin në fushën e punës. Këtu bëhet fjalë për shembull për shërbim pagesash, të cilat ndihmojnë që të ruani vendin e punës, ose përkatësisht të kërkoni një vend pune apo të vazhdoni formimin profesional.

Formimi profesional dhe riformimi në një fushë tjetër për shkak të arsyeve shëndetsore.

Shërbim pagesën për një rehabilitim ju e përfitoni vetëm nëse aftësia juaj për punë rrezikohet shumë ose është dëmtuar tashmë, për arsye të sëmundjeve ose aftësisë së kufizuar. Dhe përveç kësaj, aftësia juaj për punë duhet të rikuperohet ose të përmirësohet ndjeshëm nëpërmjet një rehabilitimi të përshtatshëm.

Përveç kësaj, në mënyrë që ju të përfitoni shërbim pagesat, duhet që të keni paguar një sasi të caktuar kontributesh. Kryesisht duhet të jenë paguar për 5 ose përkatësisht 15 vjet. Për këtë llogariten vitet në Shqipëri dhe Gjermani së bashku. Edhe këtu merren parasysh periudhat në shtetet, të cilat ushtrojnë të drejtën evropiane.

Nëse ju nuk banoni në Gjermani, duhet që në muajin kalendarik, në të cilin ju bëni kërkesën, të keni paguar një kontribut të detyrueshëm pranë sigurimit pensional gjerman. Kjo do t'ia vlente nëse ju punoni në Shqipëri me dërgim apo me një marrëveshje të posaçme.

### **Sugjerimi ynë:**

Informacion më të hollësishëm gjeni në broshurat: „Medizinische Rehabilitation: Wie Sie Ihnen hilft“, „Berufliche Rehabilitation: Ihre neue Chance“ dhe „Rehabilitation für Kinder und Jugendliche“.

## **Pensioni – çfarë avantazhesh ka marrëveshja**

**Marrëveshja rregullon ndër të tjera llogaritjen së bashku të periudhave të siguruara, pagesën e pensionit në rast banimi jashtë shtetit dhe njësimin e kërkesave për pension. Kështu, për ju është më e lehte të merrni pensione prej të dyja vendeve.**

### **Llogaritja së bashku e periudhave të siguruara**

Nëpërmjet marrëveshjes, periudhat e siguruara gjermane dhe shqiptare mund të merren parasysh së bashku. Nëse keto kohë llogariten si në Gjermani edhe në Shqipëri së bashku, atëherë ju mund të plotësoni numrin e duhur të vitete të siguruara për të përfituar pension prej të dy shteteve.

Përveç kësaj, marrëveshja bën të mundur që për të drejtën për një shërbim pagesë gjermane, përveç periudhave të siguruara gjermane dhe shqiptare mund të merren parasysh edhe periudhat e sigurimit dhe banimit në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian/ të Tregut të Përbashkët Evropian dhe Zvicrës.

Për të drejtën për një shërbim pagesë shqiptare merren parasysh edhe periudhat e siguruara të shteteve me të cilat Gjermania aplikon të drejtën evropiane dhe që Shqipëria ka mbyllur një marrëveshje mbi sigurimet shoqërore, e cila përfshin edhe pagesën e shërbim pagesave për pensionet. Deri më tani këto shtete janë Belgjika, Luksemburgu dhe Hungaria.

Për më tepër, si institucionet e sigurimit gjermane edhe ato shqiptare, marrin parasysh – nëse është e domosdoshme – periudhat e siguruara, të cilat janë realizuar në një shtet, me të cilin të dyja shtetet kanë mbyllur një marrëveshje të njëjtë mbi sigurimet shoqërore. Për momentin këto janë Turqia dhe Maqedonia.

**Ju lutemi, vini re:**

**Periudhat, të cilat mbivendosen, mund të merren parasysh vetëm njëherë. Detaje rreth kohës së pritjes dhe kushteve të veçanta ligjore për sigurimin i gjeni në faqen 23.**

Kështu, në këto rrethana ju plotësoni kushtet për të drejtën e një pensioni, të cilat nuk mund t’i plotësonit vetëm me periudhat gjermane. Anasjelltas, kështu mund të lindë edhe e drejta për pension shqiptar.

**Shembull:**

Susanne M. ka punuar katër vjet në Gjermani. Pas martesës me shqiptarin Eduard S. ajo u transferua në Shqipëri ku punoi për tre vjet si sekretare. Meqënëse për të provuar kohën e pritjes për pension merren parasysh si periudhat gjermane edhe ato shqiptare së bashku, Susanne M. i plotëson kushtet për periudhën minimale të siguruar (koha e pritjes) prej pesë vjetësh dhe kështu i lind e drejta për pension pleqërie në Gjermani.

Llogaritja së bashku e periudhave shqiptare dhe gjermane nuk rezulton në një pension shqiptaro-gjerman të mbledhur. Si institucioni i sigurimit shoqëror shqiptar, edhe ai gjerman, provojnë secili sipas të drejtës kombëtare dhe në lidhje me marrëveshjen, nëse ekziston e drejta për pension.

Nëse plotësohen kushtet në të dyja shtetet, atëherë ju përfitoni dy pensione – një shqiptar dhe një gjerman.

### **Njësimi i kërkesës për pension**

Pensionet e institucioneve shtetërore të sigurimit shqiptare dhe gjermane jepen kryesisht vetëm pasi bëhet një kërkesë. Kërkesa përcakton edhe se kur fillon pensioni.

### **Sugjerimi ynë:**

Lexoni prej faqes 53 se ku mund ta bëni kërkesën për pension shqiptar ose gjerman dhe cilat janë afatet.

Edhe këtu ju ndihmon marrëveshja: sepse ju mund ta bëni kërkesën për pension gjerman edhe pranë institucioneve shqiptare të sigurimit. Kërkesa juaj do të trajtohet sikur ju ta kishit bërë atë po atë ditë pranë institucioneve gjermane të sigurimit.

Anasjelltas, vetëkuptohet që ju mund të bëni kërkesën për pension shqiptar pranë sigurimeve gjermane. Në të njëjtën kohë, kërkesa për pension shqiptar vlen edhe si kërkesë për pension gjerman dhe anasjelltas. E rëndësishme është që ju të jepni të gjitha të dhënat e domosdoshme.

### **Shembull:**

Susanne M. banon në Gjermani dhe më 15 Janar 2018 bën kërkesën për pension pleqërie pranë institucionit përkatës gjerman të sigurimeve. Në formularin e kërkesës ajo shënon se ka paguar kontribute edhe në Shqipëri. Institucioni gjerman fillon procedurën e pensionit për Susanne M. edhe pranë institucioneve shqiptare të sigurimit.

Nëse ju nuk dëshironi që kërkesa për pension gjerman të vlejë edhe si kërkesë për pension shqiptar dhe anasjelltas, atëherë mund ta specifikoni këtë gjë pranë institucionit të sigurimeve ku bëni kërkesën. Kjo është e mundur vetëm për pensionin e pleqërisë.

**Ju lutemi, vini re:**

**Për shkak të rregullave të ndryshme kombëtare, pensioni juaj shqiptar mund të dalë më herët se ai gjerman. Në mënyrë që të mos keni disavantazhe për shkak të kërkesës së vonuar, ju lutemi të kontaktoni institucionin shqiptar të sigurimeve, për të sqaruar të drejtat tuaja shqiptare dhe kështu ta bëni kërkesën në kohën e duhur.**

## **Kushtet bazë për pension gjerman**

**Në mënyrë që të përfitohet një pension në Gjermani duhet që të plotësohen disa kushte të caktuara. Kjo mund të jetë për shembull një moshë e caktuar dhe një periudhë minimale e siguruar (koha e pritjes).**

Kushti bazë për të gjithë pensionet gjermane është që ju të keni paguar një numër të caktuar kontributesh. Kjo periudhë minimale e sigurimit quhet koha e pritjes. Sipas llojit të pensionit, koha e pritjes mund të jetë 5, 35 ose 45 vjet. Koha e pritjes prej 5 vjetësh quhet edhe koha e përgjithshme e pritjes.

Për kohën e përgjithshme të pritjes vlejnë:

- > periudhat e kontributeve (kontributet e detyrueshme dhe ato vullnetare,
- > periudhat shtesë (për shembull periudhat e përndjekjes politike në Republikën Demokratike Gjermane të atëhershme),
- > periudhat e kontributeve të shtuara për një punë më orar të pakët dhe jo me detyrim sigurimi

Për kohën e pritjes prej 35 vjetësh vlejnë gjithashtu edhe periudhat e llogaritura dhe periudhat e konsideruara. Periudhat e llogaritura janë ato, në të cilat ju jeni për shembull të sëmurë, me lejën e lindjes ose të papunë.

Edhe periudha e formimit shkollor profesional dhe të studimeve mund të jetë periudhë e llogaritur. Periudha të konsideruara janë koha e edukimit të fëmijëve ose kur jeni nën përkujdesje.

Për kohën e pritjes prej 45 vjetësh vlejné:

- > periudhat e kontributeve të detyrueshme për një punë të siguruar apo një aktivitet vetëpunësimi,
- > periudhat shtesë (për shembull, periudhat e përndjekjes politike në Republikën Demokratike Gjermane të atëhershme),
- > muajt e kohës së pritjes për punë me pak orë (e ashtuquajtura Minijob), kur gjatë tyre nuk janë paguar kontribute të detyrueshme,
- > periudhat e konsideruara
- > kontributet vullnetare, kur janë paguar kontribute të detyrueshme për një punë të siguruar ose aktivitet vetëpunësimi për të paktën 18 vjet,
- > periudhat e llogaritura për shkak të lidhjes me shërbim pagesat gjatë papunësisë ose gjatë sëmundjeve apo periudhat kalimtare.

Ato që nuk merren parasysh janë disa periudha të llogaritura të caktuara (për shembull ato të shkollës), periudhat e përfitimit të ndihmës monetare për papunësi II ose ndihmë gjatë papunësisë dhe periudhat e shpërblimit apo të ndarjes së pensionit.

Në dy vitet e fundit para fillimit të pensionit, kontributet vullnetare nuk llogariten më, nëse në të njëjtën kohë kjo është edhe një periudhë e llogaritur papunësie. Periudhat e papunësisë gjatë të cilave janë marë ndihma monetare, nuk vlejné nëse papunësia nuk ka ardhur si pasojë e një falimentimi apo mbylljeje të aktivitetit nga ana e punëdhënit.

Për kohën e pritjes vlejné edhe periudhat, të cilat ju i keni realizuar në Shqipëri apo vende të tjera anëtare.



Për kohën e pritjes prej 45 vjetësh nuk mund të llogariten periudhat e mëposhtme të realizuara jashtë shtetit.

- > periudhat e kontributeve vullnetare, kur nuk janë realizuar 18 vite me kontribute të detyrueshme për një punë të siguruar ose aktivitet vetëpunësimi në Gjermani ose Shqipëri ose në një vend tjetër anëtar,
- > kontributet për periudhat në të cilat ju nuk keni punuar (të ashtuquajturat periudha banimi),
- > periudhat e papunësisë në dy vitet e fundit para pensionit, nëse papunësia nuk është pasojë e një falimentimi apo mbylljeje e aktivitetit të punëdhënësit,
- > kontributet vullnetare në dy vitet e fundit para pensionit, nëse në të njëjtën kohë kjo është edhe një periudhë gjermane e llogaritur papunësie ose periudhë papunësie në Shqipëri ose në një vend tjetër anëtar, dhe
- > periudhat e papunësisë gjatë të cilave janë përfituar ndihma monetare papunësie II ose një ndihmë e ngjashme për papunësinë.

**Sugjerimi ynë:**

Se cilat kohë pritjeje përmbushni ju, e mësoni në informacionin personal rreth pensionit, të cilin e merrni njëherë në tre vjet, pasi keni mbushur moshën 55 vjec.

### **Kushte të vçanta ligjore për sigurimin**

Përveç periudhës minimale të siguruar, për disa lloje pensionesh gjermane, ju duhet të keni realizuar edhe një numër të caktuar kontributesh të detyrueshme për një punë të siguruar ose aktivitet vetëpunësimi. Kjo vlen ndër të tjera për pensionin e aftësisë së pakësuar për punë. Në këtë rast duhen për shembull, tre vite me kontribute të detyrueshme në pesë vitet e fundit.

Kontributet e domosdoshme ju mund t'i plotësoni edhe me kontributet përkatëse në Shqipëri ose në vende të tjera anëtare.

Nëse në periudhën kohore të parashikuar nuk janë realizuar kontributet e detyrueshme në një punë të siguruar ose aktivitet vetëpunësimi, kjo periudhë kohore mund të shtyhet pas me disa muaj në të kaluarën. Kështu mund të mundësohet që të merren parasysh edhe disa kontribute të detyrueshme.

Si periudha të cilat e zgjatin periudhën kohore, vlejné edhe periudhat e rritjes së fëmijëve në Shqipëri dhe periudhat shqiptare, në të cilat janë paguar:

- > një pension invaliditeti ose pleqërie
- > shërbim pagesa për shkak të sëmundjes, shtazanisë ose lejes së lindjes dhe
- > shërbim pagesa për shkak të papunësisë.

## **Pensioni i duhur gjerman për ju**

**Sigurimi pensional gjerman paguan pensione për shkak të uljes së aftësisë për punë, pension pleqërie dhe pension familjar. Lexoni më poshtë, se kundrejt cilave kushte mund të përfitoni ju një prej këtyre pensioneve.**

Ju mund të përfitoni një pension nga sigurimi pensional gjerman kur ju është ulur aftësia për të punuar (pension për shkak të uljes së aftësisë për punë), kur arrini një moshë të caktuar (pension pleqërie) dhe në rastin e vdekjes së të sigurvearit si e ve, i ve ose jetim (pension familjar).

Nëse doni të mësoni se për cilin pension i përmbushni ju kushtet, bëni një kërkesë për informacion rreth pensionit pranë institucionit të sigurimeve tuaja.

### **Pensioni për shkak të uljes së aftësisë për punë**

Këtë pension e merrni, nëse

- > aftësia juaj për punë është e ulur, pra jeni në gjendje të punoni më pak se gjashtë orë në ditë,
- > e plotësoni kohën e pritjes prej pesë vitesh (ose për shembull e plotësoni para kohe për shkak të një aksidenti në punë) dhe
- > gjatë pesë viteve të fundit para uljes së aftësisë për punë të keni paguar tre vjet kontribute të detyrueshme për një punësim të sigurvearit ose për një vetëpunësim.

**Ju lutemi, vini re:**

**Nëse para dt. 1 janar të vitit 1984 keni plotësuar kohën e përgjithshme të pritjes prej pesë vjetësh, ju keni të drejtë për pension edhe pa tre vite me kontribute të detyrueshme brenda periudhës kohore prej 5 vjetësh. Për këtë duhet që çdo muaj para dt. 1 janar të vitit 1984 deri në fillimin e uljes së aftësisë për të punuar të realizohet e ashtuquajtura periudha e ruajtjes së të drejtës.**

Institucioni juaj i sigurimit të pensionit shqyrton me anë të dokumentave, nëse aftësia juaj për punë është e ulur pjesërisht apo plotësisht.

Pensionin për shkak të uljes së plotë të aftësisë për punë ju e merrni, nëse ju mund të punoni më pak se tre orë në ditë. Nëse ju mund të punoni me shumë se tre, por më pak se gjashtë orë në ditë, atëherë ju merrni një pension për shkak të uljes së pjesshme të aftësisë për punë. Ky është sa gjysma e pensionit në bazë të uljes së plotë të aftësisë për punë.

Një pension për ulje të aftësisë për punë e përfitoni në shumicën e rasteve të kufizuar për tre vjet. Nëse gjendja juaj e shëndetit nuk përmirësohet gjatë kësaj kohe, pagesa e pensionit zgjatet.

**Sugjerimi ynë:**

Informacione të hollësishme gjeni në broshurën "Erwerbsminderungsrente: Das Netz für alle Fälle".

### **Pensioni i pleqërisë – mundësitë e ndryshme**

Në Gjermani mund të paguhen pensione pleqërie të ndryshme. Për cdo lloj pensioni ka kushte të caktuara.

Se cilin pension përfitoni ju, varet ndër të tjera nga mosha juaj dhe nga kohëzgjatja e sigurimit. Për shkak se mosha mesatare e jetëgjatësisë është rritur dhe numri i lindjeve është zvogëluar, edhe mosha e daljes në pension është rritur gradualisht nga 65 vjeç në 67 vjeç, në mënyrë që të ruhet ekuilibri i sigurimeve shtetërore pensionale. Duke filluar me vitin e lindjes 1947 fillon rritja e moshës së pensionit prej vitit 2012, si fillim me një muaj. Prej 2024 me dy muaj dhe kështu, për ata që kanë lindur në 1964 vlen mosha 67 për të dalë në pension. Pra, këta mund të përfitojnë pensionin e rregullt të plote në moshën 67 vjeç.

Në rastin e pensionit të pleqërisë, për të cilin ju keni të drejtë para se të mbushni moshën e caktuar për pension të rregullt, ju duhet të keni parasysh disa kufij të të ardhurave shtesë, nëse dëshironi të përfitoni pension të plotë pleqërie. Këu merren parasysh edhe të ardhurat jashtë shtetit.

### **Pensioni i rregullt i pleqërisë**

Kur ju të arrini moshën për pension të rregullt pleqërie dhe keni përmbushur kohën e përgjithshme të pritjes prej 5 vjetësh, ju përfitoni pension të rregullt pleqërie.

Pensioni i rregullt i pleqërisë për personat që kanë lindur para 1947 përfitohet në moshën 65 vjeç. Nëse ju keni lindur midis vitit 1947 dhe 1963, mosha e pensionit do t'ju rritet gradualisht. Ju përjashtoheni nga rritja e moshës së pensionit nëse keni lindur para janarit të vitit 1955 dhe keni bërë një marrëveshje me punëdhënësin tuaj para datës 1 janar 2007 rreth moshës së pleqërisë për punën me orar të pjesshëm. Për personat që kanë lindur në 1964 dhe më vonë, mosha për pension të rregullt është 67 vjeç.

Si përfitues i pensionit të rregullt të pleqërisë ju mund të fitoni të ardhura të tjera pa kufi, pa pasur frikë se mos ndoshta ju shkurtohet pensioni.

### **Pension i pleqërisë për të siguruarit me afat të gjatë**

Ju keni të drejtë për këtë pension pasi të keni përmbushur 35 vite të kohës së pritjes. Moshë e daljes në pension varet nga viti i lindjes.

Nëse keni lindur para 1949-ës, mosha e pensionit është 65 vjeç. Nëse dëshironi të dilni në pension në moshën 63 vjeç, duhet të merrni parasysh një shkurtrim pensioni prej 7.2 përqind. Nëse keni lindur midis 1949-ës dhe 1963-it, mosha për të dalë në pension do të rritet gradualisht. Nëse keni lindur në 1964-ën ose më vonë, mosha e pensionit është 67 vjeç. Ju mund të dilni në pension para kohe me 63 vjeç, por në këtë rast duhet të merrni parasysh një shkurtrim pensioni prej 14.4 përqind.

Për të siguruarit, të cilët kanë lindur para 1 janarit 1955 dhe që kanë një marrëveshje me punëdhënësin e tyre para datës 1 janar 2007 rreth moshës për punë të pjesshme sipas ligjeve gjermane, mosha e daljes në pension ngelet 65 vjeç. Këta persona mund të dalin në pension 65 vjeç pa pasur shkurtime pensioni ose me 63 vjeç me shkurtime.

Në raste të veçanta mund të përfitoni pension pleqërie me shkurtime që në moshën 62 vjeç. Për këtë informohuni, ju lutemi, pranë institucionit të sigurimeve tuaja pensionale.

### **Pension i pleqërisë për raste të veçanta të siguruarish me afat të gjatë**

Këtë pension pleqërie ju e përfitoni nëse jeni të paktën 63 vjeç dhe keni një kohë pritjeje prej 45 vjetësh.

Për të gjithë ata që kanë lindur qysh prej 1953-it rritet mosha e pensionit të pleqërisë prej 63 vjeç, gradualisht. Nëse ju keni lindur më 1964-ën ose më vonë, atëherë mosha e pensionit është 65 vjeç.

Pensioni i pleqërisë në raste të veçanta të siguruarish afatgjatë paguhet pa shkurtime. Ai nuk mund të përfitohet para kohe.

**Pensioni i pleqërisë për persona me aftësi të kufizuar shumë**

Ju keni të drejtë për këtë pension pleqërie nëse keni arritur një moshë të caktuar, jeni cilësuar sipas ligjeve gjermane si person me aftësi të kufizuar shumë me të paktën 50 përqind dhe keni plotësuar një kohë pritjeje prej 35 vjetësh. Moshë e daljes në pension varet nga viti i lindjes.

Nëse keni lindur para 1 janarit 1952, mund të dilni në pension kur të perfundoni moshën 60 vjeç. Pension pa shkurtime e përfitoni në moshën 63 vjeç.

Për personat që kanë lindur pas 31 dhjetorit 1951 dhe para 1 janarit 1964, moshë e pensionit më e hershme e mundshme (me shkurtime) rritet gradualisht në 62 vjeç. Paralelisht rritet edhe moshë e pensionit (pa shkurtime) gradualisht duke filluar me personat e lindur në 1952-in.

Për të gjithë ata që kanë lindur prej 1964-ës, moshë e daljes në pension është 65 vjeç. Me shkurtime, pensioni mund të përfitohet që në moshën 62 vjeç.

Rregullat mbi mbrojtjen e pritshmërisë së ligjshme ju mundësojnë në rrethana të caktuara që të dilni në pension në moshën 60 ose 63 vjeç pa shkurtime pensioni. Për këtë informohuni pranë institucionit të sigurimeve tuaja pensionale.

Pensionin për persona me aftësi shumë të kufizuara e përfitoni vetëm si person me aftësi shumë të kufizuara sipas ligjeve gjermane me një aftësi të kufizuar prej të paktën 50 përqind (domethënë duhet të paraqisni certifikatën që e vërteton këtë)

Një invaliditet sipas ligjeve shqiptare nuk është i njëjtë me aftësinë e kufizuar shumë gjermane. Nëse banoni në Shqipëri, atëherë zyra e përkujdesjes në Fulda provon nëse plotësohen kushtet mjekësore për një gradë prej të paktën 50 përqind të aftësisë së kufizuar dhe në këtë rast lëshon vërtetimin për t'ia paraqitur sigurimeve pensionale.

Për të vërtetuar aftësinë e kufizuar shumë, zyra e përkujdesjes kërkon dokumenta mjekësorë si për shembull raportet me diagnozat shëndetsore, ekspertizat mjekësore dhe raportet e nxjerrjes nga shtrimet e ndryshme.

### **Sugjerimi yne:**

Informacione të detajuara rreth moshës së pensionit dhe heqjes së kufirit të moshës i gjeni në broshurën „Die richtige Altersrente für Sie“.

### **Pensionet për vejushat dhe të vetë**

Pas vdekjes së partnerit ju mund të merrni një pension për vejusha dhe të ve, nëse partneri juaj i ndjerë ka përfituar një pension deri në vdekje ose ka plotësuar kohën e pritjes prej 5 vjetësh ose këtë të fundit e ka plotësuar para kohe (për shembull nëpërmjet një aksidenti).

Përvec kësaj, partneri i lënë pas nuk duhet të martohet përsëri.

Adresa e zyrës së  
përkujdesjes në Fulda  
është:  
Hessisches Amt für  
Versorgung und  
Sociales  
-Versorgungsamt-  
Washingtonallee 2  
36041 Fulda



**Ju lutemi, vini re:**

**Partnerët e të njëjtës gjini, të cilët kanë një bashkëjetesë të regjistruar, janë të barabartë në të gjitha pikat me një martesë të vlefshme.**

Një pension për vejusha ose të ve mund të paguhet si pension i vogël ose i madh.

Që të përfitoni një pension të madh ju duhet:

- > të keni përfunduar moshën 45 vjeç (për vdekjet prej 2012-ën mosha rritet gradualisht deri në 47 vjeç)
- > të keni aftësi të ulur për të punuar ose
- > të rrisni një fëmijën tuaj ose një fëmijë të partnerit, i cili nuk e ka mbushur moshën 18 vjeç ende ose
- > të përkujdeseni në të njëjtën banesë për një fëmijë tuajin ose fëmijën e partnerit, i cili ka një aftësi të kufizuar fizike, mendore ose shpirtërore.

Pensioni i madh për vejusha ose të ve paguhet për gjithmonë. Ai është 55 përqind i pensionit të pleqërisë të të ndjerit.

Nëse ju jeni martuar para datës 1 janar 2002 dhe partneri juaj ka lindur para datës 2 janar 1962, atëherë pensioni i madh për vejusha dhe të ve përbën 60 përqind të pensionit të të sigurvearit.

Nëse ju nuk i plotësoni kushtet për një pension të madh, atëherë ju përfitoni një pension të vogël për vejusha dhe të ve. Ky i fundit paguhet për maksimumi 24 muaj kalendarikë pas vdekjes së të sigurvearit. Ai përbën 25 përqind të pensionit të të sigurvearit. Nëse ju jeni martuar para datës 1 janar 2002 dhe partneri juaj ka lindur para datës 2 janar 1962, atëherë edhe pensioni i vogël paguhet për gjithmonë.

Ju nuk keni të drejtë për pension vejushe ose të ve, nëse është bërë më herët ndarja midis pensioneve.

Nëse ju martoheni përsëri, e drejta juaj për pension si vejushë ose i ve humbet. Me anë të një kërkesë ju mund të merrni një shpërblim në pensionin tuaj.

### **Pension për jetimët**

Një pension jetimi (gjysëm pension jetimi) mund të përfitohet pas vdekjes së të siguruarit kur i ndjeri:

- > ka përfituar një pension deri në vdekje
- > në momentin e vdekjes është plotësuar koha e pritjes prej 5 vjetësh ose kjo e fundit është plotësuar para kohe (për shembull nëpërmjet një aksidenti në punë).

Nëse vdes edhe prindi tjetër, ne paguajme një pension të plotë jetimi prej periudhave të siguruara të të dy prindërve.

Një pension jetimi e përfitojnë fëmijët biologjikë dhe të adoptuar të të ndjerit dhe fëmijët e partnerit, fëmijë e përkujdesuar, nipa dhe mbesa dhe motra e vëllezër, të cilët banojnë në të njëjtën banesë. Pensioni paguhet deri në moshën 18 vjeç.

Përvec kësaj, një jetim mund ta përfitojë këtë pension maksimumi deri në pfundimin e moshës 27 vjeçare nëse është duke kryer një formim shkollor apo profesiona por, edhe nëse ai ofron shërbime vullnetare për shoqërinë ose kur ka një aftësi të kufizuar dhe nuk mund ta sigurojë dot vetë jetesën.

### **Pensione të tjera për shkak të vdekjes**

Nëse jeni divorcuar pas 30 qershorit 1977 dhe ishpartneri juaj ka vdekur, atëherë ju keni të drejtë për një pension edukimi. Këtë pension ju e përfitoni prej sigurimit tuaj, nëse jeni duke rritur e edukuar një fëmijë. E njëjta gjë vlen edhe për partneritetet në bashkëjetesë të regjistruar.

Një pension për vejusha dhe të ve pas vdekjes së partnerit të parafundit paguhet kur ju jeni martuar ose jetoni në bashkëjetesë të regjistruar pas vdekjes së partnerit të mëparshëm dhe kjo lidhje u zgjidh (për shembull për shkak të vdekjes).

Nëse martesë juaj është prishur para 1 korrikut 1977, mund të përfitohet në rrethana të caktuara një pension vejeshe ose të ve të divorcuar.

### **Sugjerimi ynë:**

Informacione të hollësishme për të gjitha pensionet pas vdekjes i gjeni në broshurën „Hinterbliebenenrente: Hilfe in schweren Zeiten“.

### **Pension për shkak të vdekjes dhe të të ardhurave**

Në rastin e pensionit për vejesha dhe të ve, tre muaj mbas vdekjes së të siguarit, kontrollohen të ardhurat e mbi tarifën e lirë prej 40 përqind. Për pensionin e jetimit nuk bëhet më llogaritja e të ardhurave qysh prej datës 1 korrik 2015.

### **Minatorët – shërbim pagesa të veçanta prej shoqërisë së sigurimit të minatorëve**

Për punonjësit e minierave, për shkak të vështirësisë së lartë dhe rreziqeve, e drejta gjermane parashikon rregulla të posaçme. Përveç kësaj, edhe marrëveshja gjermano-shqiptare parashikon lehtësira për këta persona.

Sigurimi pensional për minatorët ka, përveç pensioneve të rregullta sipas ligjeve, edhe shërbim pagesat prej shoqërisë pensionale për minatorët. Këto janë:

- > pensione për minatorët, të cilëve iu është ulur aftësia e punës prej profesionit,
- > pension për minatorët pas përfundimit të moshës 50 vjeçare,
- > pension pleqërie për minatorë me punë honorar për një afat të gjatë, si edhe
- > njësim të shërbim pagesave prej shoqërisë pensionale për minatorët.

Informacione më të hollësishme gjeni në broshurën „Bergleute und ihre rente: So sind Sie gesichert“. Ose drejtohuni direkt tek sigurimi pensional gjerman Knappschaft-Bahn-See.

## **Llogaritja e pensionit gjerman**

**Pasi e mësuat se çfarë kushtesh duhet të plotësoni për të përfituar një pension nga sigurimi gjerman pensional, juve ju intereson shuma e pensionit tuaj.**

Pensioni gjerman -edhe brenda kornizës së marrëveshjes- llogaritet vetëm për periudhat e llogaritshme sipas të drejtës gjermane. Periudhat shqiptare dhe periudhat e një shteti anëtar, të një vendi anëtar të tregut të përbashkët apo Zvicrës, kryesisht nuk kanë ndonjë efekt në pensionin gjerman. Domethënë shuma e pensionit gjerman bazohet mbi të gjitha në shumën e të ardhurave tuaja, për të cilat ju keni paguar kontribute gjatë periudhave të siguruara në Gjermani.

Në momentin e llogaritjes, janë tre faktorë kryesore që përcaktojnë formulën e pensionit: faktori i pranimit, vlera aktuale e pensionit dhe faktori i llojit të pensionit. Pikat e pagesës duhet që të llogariten.

### **Formula e pensionit:**

Shuma mujore e pensionit = x faktori i pranimit  
x vlera aktuale e pensionit  
x faktori i llojit të pensionit

**Pikët e pagesës**

Pikët e pagesës përcaktohen thelbësisht prej të ardhurave tuaja ndër vite. Këtyre ju shtohen edhe kontributet vullnetare, të cilat përlllogariten në pagesa, dhe pika pagese me një vlerë të paracaktuar (për shembull periudhat e rritjes së fëmijëve).

Të ardhurat tuaja krahasohen vit për vit me të ardhurat mesatare të të gjithë të siguruarve. Nëse ju fitoni të ardhura mesatare, merrni për këtë një pikë pagese, ose përndryshe, sipas të ardhurave, më shumë ose më pak pikë pagese.

Për personat me të ardhura nga landet e reja të Republikës Federale jepet një faktor barazimi me landet e vjetra të Republikës Federale. Këto pika pagese quhen pikat e pagesave (Lindje).

**Sugjerimi ynë:**

Informacione të hollësishme për llogaritjen e pensionit gjeni në broshurën tonë „Rente: So wird sie berechnet – alte Bundesländer“ dhe „Rente: So wird sie berechnet – neue Bundesländer“. Gjithashtu ne ju sugjerojmë broshurën „Ost-West-Rentenangleichung: Das ändert sich“.

Pikë pagesa llogariten edhe nga periudhat pa kontribute. Vlerësimi i këtyre periudhave bazohet tek të ardhurat tuaja dhe tek periudhat e siguruar gjatë gjithë jetës së siguruar.

Në fund llogariten të gjitha pikë pagesat bashkë.

### **Faktori i pranimit**

Faktori i pranimit është zakonisht 1,0. Për pensionin e pleqërisë, ky faktor bie më 0,3 përqind për cdo muaj, gjatë të cilit ju përfitoni pension të parakohshëm.

Edhe në rastin e pensionit për shkak të uljes së aftësisë për punë apo pension familjar, faktori i pranimit mund të zvogëlohet. Se sa është ulja e tij, kjo varet nga mosha e të siguruarit në momentin e fillimit të pensionit për shkak të uljes së aftësisë për punë ose përkatësisht të moshës kur vdes. Ulja mund të jetë maksimumi 10,8 përqind.

### **Vlera aktuale e pensionit**

Me vlerën aktuale të pensionit përshtatet shuma e pensionit zakonisht një herë në vit (më 1 Korrik) me zhvillimin ekonomik. Ajo është vlera mujore e pensionit, të cilën mund ta arrijë mesatarisht personi që punon me të ardhurat e një viti. Per pikë pagesen (Lindje) vlen vlera e vet aktuale e pensionit (Lindje) e përshtatur.

### **Faktori i llojit të pensionit**

Faktori i llojit të pensionit bazohet në llojin e pensionit dhe përbëhet nga:

pensionin e pleqërisë, pension për shkak të uljes së plotë të aftësisë për punë dhe pensionin për edukim	1,0
pensionin për ulje të pjesshme të aftësisë për punë	0,5
gjysëm pension jetimi	0,1
pensionin plotë jetimi	0,2
pensionin i vogël për vejtusha dhe të ve gjatë tre muajve të parë pas vdekjes të të ndjerit	1,0
dhe më vonë	0,25
pensionin i madh për vejtusha dhe të ve gjatë tre muajve të parë pas vdekjes të të ndjerit	1,0
dhe më vonë	0,55 ose 0,6

Prej këtyre faktorëve llogaritet pastaj pensioni juaj.

## **Sistemi pensional shqiptar – një përmbledhje e shkurtër**

**Sistemi i sigurimit pensional në Shqipëri ndahet në tre pjesë: sistemi i sigurimeve të detyrueshme, sigurimi vullnetar dhe sigurimi shtesë.**

Në këtë broshurë ne do t'ju japim një përmbledhje të shkurtër se cilat shërbim pagesa mund të përfitoni ju nga sistemi i sigurimit të detyrueshëm. Por nëse ju keni të drejtë pensioni, këtë mund ta vërtetojë vetëm institucioni i sigurimeve pensionale shqiptare.

### **Sistemi pensional shqiptar**

Sistemi shqiptar i sigurimit të detyrueshëm financohet, njëlloj si sistemi gjerman i sigurimit pensional, prej kontributeve të paguara. Marrja pjesë në këtë sistem është e detyrueshme për të gjithë punëmarrësit dhe të vetëpunësuarit. Përveç rreziqeve të invaliditetit, pleqërisë dhe vdekjes ai mbulon edhe rreziqet e sëmundjeve, lejes së lindjes dhe aksidenteve. Institucioni i sigurimeve të detyrueshme shoqërore për pensionin e pleqërisë, pensionin e invaliditetit si edhe atë familjar në rast vdekjeje është ISSH (Instituti i Sigurimeve Shoqërore) në Tiranë.

Adresën e gjeni në  
faqen 53.

### **Pensioni i pleqërisë**

Pensioni i pleqërisë mund të jetë i rregullt ose i shkurtuar.

### **Pensioni i rregullt i pleqërisë**

Deri në fund të 2014-ës moshë e rregullt e pensionit për gratë ka qënë 60 vjeç dhe prej vitit 2015 është rritur gradualisht në moshën 63 vjeç. Rritja bëhet me dy muaj në vit dhe do të përmbyllet në vitin 2032.

Moshë e pensionit të rregullt të pleqërisë për burrat ka filluar të rritet prej vitit 2015 deri në vitin 2032 në moshën 65 vjeç, dhe nga viti 2033 do të rritet në moshën 67 vjeç. Kjo rritje moshe bëhet me një muaj cdo vit dhe do të përmbyllet në vitin 2056.

Por kusht për të përfituar një pension të rregullt pleqërie është që ju të keni të paktën 35 vite pune të siguruara. Edhe këtu bëhet një rritje graduale në 40 vite pune nga viti 2015 deri në vitin 2025 me katër muaj në vit.

Sistemi pensional shqiptar njihet periudhat e sigurimit të detyrueshëm, periudhat e vlefshme njëloj (për shembull shërbimin ushtarak, përfitimin e ndihmës shoqërore për shkak të sëmundjes, shtatzanisë ose invaliditetit dhe kontributet vullnetare.

### **Pensioni i pleqërisë i shkurtuar**

Kusht për këtë pension pleqërie është gjithashtu që ju të keni të paktën 35 vite pune të siguruara. Edhe këtu ndodh një rritje prej 40 vitesh pune të siguruara. Ky lloj pensioni mund të përfitohet tre vjet para moshës së parashikuar nga ligji, nëse plotësohen kushtet e mësipërme. Por kjo bëhet me një shkurtim prej 0,6 përqind për cdo muaj që përfitohet pensioni para kohe. Ky shkurtim pensioni mbetet e tillë edhe për pjesën tjetër të kohës.

### **Pensioni i invaliditetit**

Ky lloj pensioni paguhet si pension i plotë invaliditeti, si pension i pjesshëm invaliditeti dhe si pension i shkurtuar invaliditeti.



### **Pensioni i plotë i invaliditetit**

Ju përfitoni një pension të plotë invaliditeti nëse jeni plotësisht të paaftë për punë dhe e keni plotësuar kohën minimale të viteve të siguruara. Ekspertiza ose përcaktimi i paaftësisë për punë bëhet me vendim të ekspertëve të vlerësimit. Koha minimale e siguruar është tre të katërtat e kohës prej moshës 20 vjec deri në momentin kur ka filluar paaftësia për punë.

### **Shembull:**

Fillimi i paaftësisë për punë bëhet në moshën 50 vjeç.  
Diferenca (50 minus 20) është 30 vjet.

Prej tyre llogariten tre të katërtat = 22,5 vite si kohë minimale e siguruar.

### **Pensioni i pjesshëm i invaliditetit**

Ju përfitoni pension të pjesshëm invaliditeti nëse jeni të paaftë të ushtroni punën tuaj të fundit, por në kushte të veçanta pune (të cilat përcaktohen me vendim të ekspertit të vlerësimit) ju mund të punoni. Për këtë lloj pensioni duhet gjithashtu të plotësohet një periudhë minimale e siguruar.

Shuma e pensionit të pjesshëm të invaliditetit përbën 50 përqind të pensionit të plotë të invaliditetit.

### **Pensioni i shkurtuar i invaliditetit**

Në rastet kur vërtetohet paaftësi e plotë për punë por që koha minimale e siguruar nuk është realizuar, atëherë lind e drejta për një pension të shkurtuar invaliditeti. Pensioni llogaritet si më poshtë:

shuma e pensionit të invaliditetit të plotë x koha minimale e siguruar e domosdoshme  
koha konkrete e siguruar

Përveç kësaj, sistemi pensional shqiptar parashikon një shtesë për personat në nevojë, e cila përbën 15 përqind të shumës bazë të llogaritur. Kjo shtesë paguhet kur personi është në nevojë për kujdesje të përhershme. Nevoja e për kujdesjes përcaktohet gjithashtu nga ekspertët mjeko-ligjorë të vlerësimit.

Gjithashtu ekziston edhe një shtesë për fëmijët në kujdestari deri në moshën 18 vjeç ose 25 vjeç në rast se janë studentë. Kjo shtesë përbën pesë përqind për secilin fëmijë por maksimumi 30 përqind.

### **Pensioni familjar**

Personat e varur prej të siguruarit të ndjerë kanë të drejtë për pension familjar, nëse i ndjeri ka ose ka pasur të drejtë të përfitojë pension. E drejta shqiptare njih përveç pensioneve të njohura në Gjermani për vejusha dhe të ve, dhe pension për jetimët, edhe pensione për të afërm të tjerë.

Personat e mëposhtëm mund të kenë të drejtë për pension familjar sipas të drejtës shqiptare për pensionet.

- > patneri i mbijetuar
- > fëmijët e të ndjerit
- > nipa/ mbesa të të ndjerit
- > prindër, gjyshër, njerë /njerka

### **Pensioni për vejusha dhe të ve**

Të drejtë pensioni për vejusha dhe të ve kanë personat, të cilët

- > kujdesen për një fëmijë të personit të vdekur deri në moshën 8 vjeç
- > janë të paaftë për punë
- > janë 55 vjeç (gratë) dhe përkatësisht 60 vjeç (burrat)

Nuk ka një të drejtë paralele për pension familjar dhe pension vetjak. Normalisht paguhet pensioni i cili është më i lartë.

Shuma e pensionit për vejusha dhe të ve përbën 50 përqind të pensionit të të ndjerit të siguruar.

**Ju lutemi, vini re:**

**Nëse ju përfitoni një pension për vejusha ose të ve dhe martoheni përsëri, atëherë e humbisni të drejtën për pension familjar.**

**Pensioni për jetimët**

Për sa kohë jetimët kanë qënë të varur prej të ndjerit, ata përfitojnë pension familjar deri në moshën 18 vjeç, deri në moshën 25 vjeç në rast studimi ose përtej këtij kufiri moshe në rast paaftësie për punë. E drejta shqiptare nuk njeh pension për fëmijët në kujdestari.

Pensioni për jetimët dhe të afërmve të tjerë që e gëzojnë këtë të drejtë përbën 25 përqind të pensionit të të siguarit të ndjerë.

**Pension familjar për të afërm të tjerë**

Edhe prindërit, gjyshrit dhe njerët kanë të drejtë për pension familjar, në rastet kur ata

- > kanë jetuar me të ndjerin për të paktën një vit

- > nuk kanë persona të tjerë për t'u kujdesur për ta
- > kanë përfunduar moshën 65 vjeçare
- > janë të paaftë për punë

Nipat e mbesat që jetojnë në të njëjtën banesë me të ndjerin dhe janë të varur prej tij, konsiderohen njëloj si femijët jetimë, domethëne ata kanë të njëjtat të drejta me kushte të njëjta.

### **Pensioni social**

Të gjithë shqiptarët që të paktën pesë vitet e fundit kanë jetuar në Shqipëri, përfitojnë një pension social pasi kanë përfunduar moshën 70 vjeç, në rast se nuk kanë të drejtë për pension nga sistemi i sigurimeve të detyrueshme ose nëse nuk kanë asnjë të ardhur tjetër.

## **Pension gjerman edhe jashtë shteti**

Pensionet prej sigurimeve pensionale gjermane paguhen në të gjithë botën. Por një qëndrim i përhershëm jashtë shtetit mund të ndikojë në shumën e pensionit dhe në rrethana të caktuara mund të çënojë të drejtën për pension.

### **Qëndrim i përkohshëm**

Nëse ju qëndroni vetëm përkohësisht jashtë shteti, ju vazhdoni ta përfitoni të plotë pensionin gjerman.

Ne e konsiderojmë një qëndrim jashtë shtetit si të përkohshëm nëse ju e dini se për sa kohë të kufizuar do të qëndroni atje dhe kur thelbi i jetës tuaj mbetet në Gjermani.

### **Shembull:**

Pensionisti Rudi M. i kalon muajt e dimrit në Tailandë. Qëndrimi i përkohshëm jashtë shtetit nuk ka ndikim në pensionin e tij gjerman.

Nëse Rudi M. synon të transferohet për banim të përhershëm jashtë shteti, kjo mund të kishte efekte negative për pensionin e tij.

**Ju lutemi, vini re:**

**Ju lutemi, informoni në kohën e duhur shërbimin e pensioneve të Deutsche Post AG (ky institucion është përgjegjës për pagesën e pensioneve në Gjermani), domethënë të paktën tre muaj para se të largoheni jashtë shtetit. Edhe nëse shuma e pensionit tuaj nuk ndryshon, ne dhe shërbimi i pensioneve duam pak kohë për ndryshimin e llogarisë bankare. Për këtë ju duhet të jepni numrin e sigurimit, adresën e re dhe llogarinë e re të bankës.**

### **Kufizime për pagesën e pensionit jashtë vendi**

Pavarësisht nga shtetësia juaj, bëhen disa kufizime në pagesën e pensionit kur në pensionin tuaj,

- > janë llogaritur periudha sipas të ashtuquajturit ligjit për pensionet e huaja, të cilat u janë llogaritur të internuarve ose migrantëve në zonat e origjinës në Evropën Lindore
- > periudhat e kontributeve në zonat e Rajhut, të cilat janë kontribute deri në fund të luftës së dytë botërore në zonat e mëparshme gjermane si për shembull në Shlezien ose Prusine Lindore

Në këtë rast pensioni juaj mund të shkurtohet ose edhe të mos paguhet fare. Kjo vlen për të gjithë, përfshi edhe gjermanët.

Një pension për shkak të paaftësisë së plotë për punë, i cili paguhet për arsye të tregut të mbyllur të punës (së pjesshme), në rrethana të caktuara mund të mos përfitohet fare, nesë ju transferoheni jashtë vendi. Pastaj ju keni të drejtë vetëm për një pension të pjesshëm për shkak të uljes së aftësisë për punë.

**Pagesa e pensionit**

Pensioni gjerman ju paguhet normalisht në fund të muajit në një llogari bankare të zgjedhur prej jush. Nëse jepni një llogari bankare jashtë shteti, atëherë mund të paguani edhe transfertën bankare. Këto kosto dhe kostot për shkak të lëkundjes së shkëmbimit valutor, për fat të keq nuk mund të mbulohen prej nesh.

**Sugjerimi ynë:**

Në mënyrë që të siguroheni se pensioni juaj nuk shkurtohet apo pezullohet kur ju shkoni jashtë shteti, informohuni pranë institucionit tuaj të sigurimit pensional për shkurtime e mundshme. Paralel me këtë, ju duhet të informoheni pranë sigurimit shëndetsor, për të mësuar nëse do të vazhdoni të jeni të siguar edhe jashtë shteti.

**Vërtetimi i jetës**

Pensionistët me banim jashtë vendi marrin një herë në vit një vërtetim jete prej shërbimit të pensioneve nga Deutsche Post AG. Ky formular duhet të vërtetohet dhe nënshkruhet sa më shpejt të jetë e mundur dhe t'i dërgohet përsëri Deutsche Post AG në mënyrë që pensioni të paguhet pa vonesa.

## **Kërkesa për pension dhe fillimi i pensionit**

**Ju duhet që të bëni kërkesë për të përfituar pensionin nga sigurimi pensional gjerman dhe shqiptar. Këtu do të mësoni se kur dhe ku mund ta bëni kërkesën.**

Pensioni shqiptar dhe gjerman paguhen normalisht në bazë të kërkesës. Prandaj edhe data e bërjes së kërkesës është e rëndësishme. Nëpërmjet marrëveshjes, një kërkesë për pension gjerman vlen edhe si kërkesë për pension shqiptar, dhe anasjelltas. Por meqënëse mosha e fillimit të pensionit, në rrethana të caktuara është ndryshe nga ajo në Gjermani, ne ju këshillojmë që të informoheni në kohë pranë sigurimeve shqiptare, në mënyrë që të mos e humbisni afatin e aplikimit.

**Ju lutemi, vini re:**

**Mos harroni që në kërkesën për pension shqiptar, të shënoni edhe periudhat gjermane, nëse kërkesën e bëni pranë sigurimeve pensionale shqiptare. E njëjta gjë vlen edhe për kërkesën për pension gjerman. Edhe këtu ju duhet të shënoni periudhat e siguruara në Shqipëri.**



Pensionet gjermane fillojnë zakonisht më datën një të muajit kalendarik, në fillim të të cilit plotësohen kushtet për pension.

**Shembull:**

Markus M. e përfundon moshën 65 vjeçare më 16 Mars 2018. Në këtë moment plotësohen edhe kushtet për pensionin e rregullt të pleqërisë. Pensioni i tij fillon më 1 prill 2018.

Por nëse ju e bëni kërkesën për pension tre muaj pas datës kur duhet të fillonte pensioni, ose edhe më vonë, atëherë pensioni fillon në datën një të muajit në të cilin është bërë kërkesa.

Përrjashtime ka për pensionet për shkak të uljes së aftisë për punë dhe pensione familjare. Pensioni i përkohshëm për shkak të uljes së aftësisë për punë ka si afat shtatë muaj kalendarikë pasi ka filluar ulja e aftësisë për punë. Nëse ju e bëni kërkesën pasi ka mbaruar ky afat, atëhere pensioni fillon me muajin në të cilin bëhet kërkesa. Një pension familjar mund të paguhet edhe për kohën e kaluar deri në dymbëdhjete muaj para muajit në të cilin bëhet kërkesa.

## **Mundësoni vërtetimin e të drejtave tuaja**

**E drejta për shërbim pagesa në bazë të marrëveshjes mund të përfitohet për herë të parë me futjen në fuqi të marrëveshjes, domethënë më 1 dhjetor 2017. Pensionet të cilat janë paguar para futjes në fuqi të marrëveshjes, mund të rishqyrtohen.**

Nëse deri tani ju nuk përfitoni pension, sepse nuk i përmbushnit kushtet (për shembull nuk plotësonit kohën e pritjes), kjo mund të ndryshojë me llogaritjen së bashku të periudhave shqiptare dhe gjermane dhe kështu ju mund të përfitoni të drejtën për pension. Këtu llogariten edhe periudhat e siguruar në një vend anëtar të BE-, Treugt të Përbashkët Evropian dhe përkatësisht Zviccrës, Maqedonisë dhe Turqisë.

Edhe pensionet, të cilat janë përcaktuar para futjes në fuqi të marrëveshjes mund të rishqyrtohen. Marrja parasysh e periudhave të siguruar në Shqipëri mund të sjellë një rritje të shumës së pensionit.

### **Sigjerimi ynë:**

Në mënyrë që të provoni nëse ju me të vërtetë keni avantazhe prej marrëveshjes, ju lutemi të kontaktoni sa më parë institucionin përkatës të sigurimeve pensionale.

Adresat i gjeni në faqen 54.

## **Sigurimi shëndetsor dhe ai i përkujdesjes për ju si pensionistë**

**Marrëveshja gjermano-shqiptare vlen për sigurimin shtetëror pensional – por nuk vlen për sigurimin shëndetsor dhe të përkujdesjes për pensionistët. Në këtë kapitull ju mësoni kur jeni të siguar për shëndetin në Gjermani ose Shqipëri.**

Në qoftë se ju banoni në Gjermani, keni sigurimin e detyrueshëm pranë sigurimeve shëndetsore gjermane për pensionistë, nëse për një kohë të caktuar para fillimit të pensionit ju keni qënë anëtar i sigurimeve shtetërore shëndetsore.

Gjatë procesit të përcaktimit të pensionit, sigurimi juaj shëndetsor shqyrton nëse ju i plotësoni kushtet për një pension të detyrueshëm.

Një sigurim i detyrueshëm në sigurimin shëndetsor për pensionistët përfshin gjithmonë edhe një sigurim të detyrueshëm për sigurimin e përkujdesjes.

Kontributet për sigurimin shëndetsor dhe atë të përkujdesjes mbahen direkt prej pensionit tuaj nga institucioni i sigurimit pensional gjerman dhe paguhen në sigurimin shëndetsor.

Ju lutemi drejtohuni pranë sigurimit tuaj shëndetsor nëse keni pyetje.

**Ju lutemi, vini re:**

**Pensioni juaj shqiptar ose një tjetër i huaj janë gjithashtu të përfshirë nga kontributet e detyrueshme, nese jeni të siguruar në institucionin e sigurimeve shëndetsore për pensionistët.**

Nëse ju si pensionistë transferoheni në Shqipëri përgjithmonë, anëtarësia juaj e detyrueshme në sigurimin shtetëror gjerman shëndetsor dhe të përkujdesjes shlyhet. Kjo vlen edhe nëse ju në Shqipëri përfitoni vetëm një pension gjerman. Në rrethana të veçanta ekziston mundësia, kur jeni të siguruar pranë një sigurimi shëndetsor privat, i cili është nën kontrollin e zyrave shtetërore gjermane ose të ndonjë shteti tjetër anëtar, që të keni të drejtë për një pagesë shtesë. Nuk ka asnjë sigurim shëndetsor privat shqiptar, i cili ofron mundësinë për pagesë shtesë.

**Sugjerimi ynë:**

Nëse ju transferoheni në Shqipëri, informohuni në kohë, ju lutemi, pranë sigurimit tuaj shëndetsor për pasojat e mundshme.

Nëse banoni në Shqipëri, nuk jeni më të detyruar për të qënë të siguruar në sigurimin shtetor gjerman shëndetsor dhe atë të përkujdesjes.

Por Shqipëria ka në fakt një sistem të sigurimit shëndetsor. Pranë sigurimit shtetëror shëndetsor janë të detyruar të sigurohen ndër të tjerë, punëmarrësit, të vetëpunësuarit, fermerët, përfituesit e një pensioni shqiptar dhe përfituesit e ndihmës sociale shqiptare. Pensionistët gjermanë, të cilët transferohen në Shqipëri, nuk janë të detyruar për të qënë të siguruar në sigurimin shqiptar shëndetsor, për sa kohë ata nuk përfitojnë pension shqiptar.

## **Partnerët tuaj të kontaktit**

**Në këtë broshurë ju gjeni një përmbledhje të përgjithshme rreth marrëveshjes dhe shërbim pagesave të sigurimeve pensionale gjermane dhe shqiptare. Meqënëse këtu nuk mund të shqyrtohen të gjitha hollësitë, mund të lexoni në këtë kapitull se cilit institucion gjerman të sigurimeve pensionale mund t'i drejtoheni për pyetjet që keni dhe gjithashtu edhe partnerët tuaj të kontaktit në Shqipëri.**

### **Partneret tuaj të të kontaktit në Shqipëri**

Përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave dhe pyetjeve sipas marrëveshjes në Shqipëri është Instituti i Sigurimeve Shoqërore në Tiranë (ISSSH).

Instituti i Sigurimeve Shoqërore  
Rruga e Durrësit, nr. 83  
1001 Tiranë  
Albania

### **Partnerët tuaj të kontaktit në Gjermani**

Për pyetje dhe kërkesa në lidhje me Shqipërinë, ju lutemi të drejtoheni pranë institucioneve të sigurimit të mëposhtme:

- > Deutsche Rentenversicherung Bund,
- > Deutsche Rentenversicherung Knappschaft-Bahn- See,
- > Deutsche Rentenversicherung Rheinland-Pfalz,
- > Sozialversicherung für Landwirtschaft, Forsten und Gartenbau.

Përgjegjës për ju është institucioni i sigurimeve pranë të cilit ju keni paguar kontributet për herë të fundit. Nëse nuk e dini se cili është ky institucion, atëherë zgjidhni njërin prej tyre. Ky i fundit kërkon pastaj se cili institucion është përgjegjës për ju.

Nëse kontributet e fundit i keni paguar pranë Deutsche Rentenversicherung Bund (enti i dikurshëm i sigurimeve për punonjësit) drejtohuni tek:

Deutsche Rentenversicherung Bund

Telefon 030 865-0

Telefax 030 865-27240

E-Mail [meinefrage@drv-bund.de](mailto:meinefrage@drv-bund.de)

Internet [www.deutsche-rentenversicherung-bund.de](http://www.deutsche-rentenversicherung-bund.de)

Nëse ju ndonjëherë keni paguar të paktën një kontribut gjerman pranë institucionit Deutsche Rentenversicherung Knappschaft-Bahn-See (dikur Bundesknappschaft, Bahnversicherungsanstalt und Seekasse), partneri i kontaktit është:

Deutsche Rentenversicherung Knappschaft-Bahn-See

Telefon 0234 304-0

Telefax 0234 304-66050

E-Mail [rentenversicherung@kbs.de](mailto:rentenversicherung@kbs.de)

Internet [www.kbs.de](http://www.kbs.de)

Nëse kontributet e fundit i keni paguar në një institucion rajonal (institucioni i dikurshëm për sigurimet e Landit) atëherë partneri juaj i kontaktit është:

Deutsche Rentenversicherung Rheinland-Pfalz

Eichendorffstraße 4-6

67346 Seyer

Telefon 06232 17-0

Telefax 06232 17-2589  
e-mail service@drv-rlp.de  
internet www.deutsche-rentenversicherung-rip.de

Nëse i keni paguar kontributet pranë Sozialversicherung für Landwirtschaft, Forsten und Gartenbau (sigurimi i dikurshëm i pensionit të pleqërisë për bujqësinë) partneri juaj i kontaktit është:

Sozialversicherung für Landwirtschaft, Forsten und Gartenbau (SVLFG)  
Postfach 10 13 40  
34013 Kassel  
Telefon 0561 9359-0  
Telefaks 0561 9359-217  
e-mail poststelle@svlfg.de  
internet www.svlfg.de

**Sugjerimi ynë:**

Nëse nuk keni paguar kontribute gjermane, drejtuhuni pranë Deutsche Rentenversicherung Bund. Ky i fundit ju drejton pastaj tek institucioni përgjegjës.

Për pyetje rreth një marrëveshjeje të posaçme drejtuhuni tek:

GKV-Spitzenverband  
Deutsche Verbindungsstelle Krankenversicherung  
Ausland (DVKA)  
Pennefeldsweg 12c  
53177 Bonn  
Telefon 02289530-0  
Telefaks 0228 9530-0  
e-mail post@dvka.de  
internet www.dvka.de

## **Vetëm një hap larg: Sigurimi juaj pensional**

A keni akoma pyetje? Ju keni nevojë për informacione ose dëshironi një këshillim individual? Ne jemi të gatshëm për ju: kompetent, asnjans, falas.

### **Me broshurat tona informuese**

Oferta jonë e broshurave ka një larmi të gjerë. Ato që ju interesojnë mund t'i porositni ose shkarkoni në [www.deutsche-rentenversicherung.de](http://www.deutsche-rentenversicherung.de). Këtu ne ju tërheqim vëmendjen për oferta të veçanta të këshillimit.

### **Në telefon**

Pyetjeve tuaja ne u përgjigjemi në telefonin e shërbimit pa pagesë. Atje mund të porositni edhe material informacioni dhe formularë ose mund të pyesni për partnerin e përshtatshëm të kontaktit në vend. Ju mund të na kontaktoni nën 0800 10004800.

### **Në Internet**

Oferta jonë nën [www.deutsche-rentenversicherung.de](http://www.deutsche-rentenversicherung.de) qëndron 24 orë në dispozicionin tuaj. Ju mund të informoheni mbi shumë tema dhe mund të shkarkoni ose porositni formularë dhe broshura. Me shërbimet tona online ju mund t' i zgjidhmi të sigurt dhe nga shtëpia çështjet tuaja.

### **Në bisedën personale**

Qendrën më të afërt të informacionit dhe të këshillimit e gjeni në faqen bazë të internetit tonë ose interesoheni për këtë në telefonin e shërbimit. Atje mund të lini edhe rehatshëm një takim ose e prenotoni atë online. Nëse jeni në lëvizje ju ndihmon aplikacioni ynë iRente.

### **Këshilltarët e sigurimeve dhe kujdestarët e sigurimeve**

Edhe këshilltarët tanë dhe respektivisht kujdestarët për sigurime, të cilët veprojnë vullnetarisht, janë shumë afër vendbanimit tuaj të gatshëm për ju dhe ju ndihmojnë për shembull gjatë plotësimit të formularëve të aplikimit.

### **Linja jonë e shpejtë**

080010004800 (numër pa pagesë për Gjermani) [www.deutsche-rentenversicherung.de](http://www.deutsche-rentenversicherung.de) [info@deutsche-rentenversicherung.de](mailto:info@deutsche-rentenversicherung.de)



Këshillime shumëgjuhëshe mund të ofrojmë në ditën ndërkombëtare të këshillimit. Takimet i gjeni në internet.

### **Partnerët tanë**

Ju mund ta bëni kërkesën për pension, të merrni formularë ose të përcillni dokumentacionin edhe pranë zyrave bashkiake apo komunale.

### **Institucionet e sigurimit pensional gjerman.**

**Deutsche Rentenversicherung  
Baden-Württemberg** Gartenstraße 105  
76135 Karlsruhe  
Telefon 0721 825-0

**Deutsche Rentenversicherung  
Bayern Süd** Am Alten Viehmarkt 2  
84028 Landshut  
Telefon 0871 81-0

**Deutsche Rentenversicherung  
Berlin-Brandenburg** Bertha-von-Suttner-Straße 1  
15236 Frankfurt/Oder  
Telefon 0335 551-0

**Deutsche Rentenversicherung  
Braunschweig-Hannover** Lange Weihe 2  
30880 Laatzen  
Telefon 0511 829-0

**Deutsche Rentenversicherung  
Hessen** Städelstraße 28  
60596 Frankfurt/Main  
Telefon 069 6052-0

**Deutsche Rentenversicherung  
Mitteldeutschland** Georg-Schumann-Straße 146  
04159 Leipzig  
Telefon 0341 550-55

**Deutsche Rentenversicherung  
Nord** Ziegelstraße 150  
23556 Lübeck  
Telefon 0451 485-0

<b>Deutsche Rentenversicherung Nordbayern</b>	Wittelsbacherring 11 95444 Bayreuth Telefon 0921 607-0
<b>Deutsche Rentenversicherung Oldenburg-Bremen</b>	Huntestraße 11 26135 Oldenburg Telefon 0441 927-0
<b>Deutsche Rentenversicherung Rheinland</b>	Königsallee 71 40215 Düsseldorf Telefon 0211 937-0
<b>Deutsche Rentenversicherung Rheinland-Pfalz</b>	Eichendorffstraße 4-6 67346 Speyer Telefon 06232 17-0
<b>Deutsche Rentenversicherung Saarland</b>	Martin-Luther-Straße 2-4 66111 Saarbrücken Telefon 0681 3093-0
<b>Deutsche Rentenversicherung Schwaben</b>	Dieselstraße 9 86154 Augsburg Telefon 0821 500-0
<b>Deutsche Rentenversicherung Westfalen</b>	Gartenstraße 194 48147 Münster Telefon 0251 238-0
<b>Deutsche Rentenversicherung Bund</b>	Ruhrstraße 2 10709 Berlin Telefon 030 865-0
<b>Deutsche Rentenversicherung Knappschaft-Bahn-See</b>	Pieperstraße 14-28 44789 Bochum Telefon 0234 304-0

**Impresum**

Botuesi: Deutsche Rentenversicherung Bund

Sektori i marrëdhënieve me shtypin dhe publikun, komunikimi

10709 Berlin, Ruhrstraße 2

Adresa postare: 10704 Berlin

Telefon: 030 865-0, Telefax: 030 865-27379

E-mail: drv@drv-bund.de

Ilustrimet: arshiva e fotografive Deutsche Rentenversicherung Bund

Shtypshkronja: Fa. H. Heenemann GmbH & Co., Berlin

Botimi i 1-rë (11/2018), **nr. 777**

Kjo broshurë është pjesë e marrëdhënieve publike të sigurimit pensional gjerman; ajo parimisht jepet falas dhe nuk është e destinuar për shitje.

Pensioni shtetëror është dhe mbetet guri i themelit për sigurimin e pleqërisë.

Partner kompetent në çështjet e përkujdesjes për pleqërinë është sigurimi pensional gjerman. Ai kujdeset për më shumë se 54 milionë të siguar dhe rreth 21 milionë pensionistë.

Kjo broshurë është pjesë e ofertës sonë të gjithanshme të këshillimit.

Ne informojmë.

Ne këshillojmë. Ne ndihmojmë.

Sigurimi pensional gjerman